


- Sigurohuni që nuk keni vënë ndonjë informacion personal në profilin tuaj. Kjo përfshinë numrin tuaj të telefonit, email adresën personale, adresën e shtëpisë ose emrin e shkollës suaj. Të jeni të kujdesshëm që asnjëherë kur ju postoni foto, mos të përfshijnë ndonjë nga këto informacione.
- Keni kujdes në atë që ju postoni në internet, nëse një herë ju postoni diçka online (fjalë, foto, video), ju humbni kontrollin mbi atë informacion. Ky informacion mund të kopjohet, prehet dhe të ngjitet kudo. Kjo përfshinë profilet private.
- Mendo dy herë! Postimet në profilet dhe blog-et mund të qëndrojnë përgjithmonë. Prindërit tuaj, punëdhënësit e ardhshëm (dhe ndoshta fëmijët tuaj) mund t'i shohin ato.
- Mbani mend: Jo të gjithë, janë ata që pretendojnë të jenë. Është mirë që të keni shumë miq online, por me këtë ju u lejoni njerëzve të dinë gjithçka për ju. Ky informacion mund të përdoret për të vjedhur identitetin tuaj, ose edhe më keq.
- Mos postoni fotot e njerëzve të tjerë pa lejen e tyre.
- Mos harroni, kur ju postoni fotot ju gjithashtu mund të dëmtoni privatësinë e miqve tuaj.
- Mos u përgjigjini nëse dikush ju dërgon mesazhe ngacmuese ose kërcnuese, ose kërkon që ju të bëni diçka që ju bën të ndjeheni pakëndshëm. Në vend të kësaj, tregonju prindërve tuaj ose një të rrituri që ju i besoni.
- Mos i ndani fjalëkalimet me askënd.
- Mirëpo nëse patjetër duhet të takoheni, merrni me veti prindin apo shokët tuaj dhe takohuni në një vend publik.
- Pranoni kërkesa për shoqërim vetëm nga njerëzit që i njihni personalisht.
- Mos postoni përmbajtje të cilat nuk doni të shihen nga prindërit, mësuesit ose bashkëpunëtorët.
- Mëso për rregullat e privatësisë dhe përditësoni ato shpesh.

Rezultatet nga hulumtimi i Qendrës FIT me fëmijët e moshës 9 -16 vjet i mbajtur në Prill 2012 në Prishtinë tregojnë se:

- 87% e fëmijëve kanë llogari të veten në Facebook ose Twitter, prej të cilëve 43% e tyre kanë mbi 400 "miq";
- 89% postojnë fotografinë në profil, 71% emrin e shkollës kurse 50% e-mail adresën e tyre;
- 16% kanë deklaruar se u janë keqpërdorur të dhënat personale;
- 50% kanë deklaruar se kompjuteri i tyre është sulmuar nga ndonjë virus;
- 58% kanë takuar dikë personalisht të cilin së pari e kanë njohur përmes internetit prej të cilëve 27% janë shqetësuar (pënguar, nervozuar, mërzhitur, lënduar) nga këto takime;
- 42% kanë parë foto ose video me përmbajtje erotike, prej të cilëve 13% kanë parë çdo ditë;
- 37% e fëmijëve kanë deklaruar se kanë përjetuar sajberdhunën prej të cilëve 41% përmes rrjeteve sociale.

Aktivitetet që më së shumti ju pëlqejnë fëmijëve në internet janë: Facebooku (74%), Youtube (66%), muzika (63%), lojërat (50%), msn (35%), kërkim në ueb (32%) dhe tjeta (7%).

A keni llogari tuajën në Facebook ose Twitter ?



Burimi: Qendra FIT



"Ky projekt u financua përmes grantit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit."



Qendra për studime të avancuara
Center for advanced studies

Që ju të jeni më të sigurt në RRJETET SOCIALE



Internet i Sigurt

www.internetisigurte.org

Rrjetet sociale janë komunitete virtuale që mundësojnë qasje në kohë reale, sinkronizim të komunikimit, mundësi të postimit dhe ndarjes së fotove, videove, punës origjinale dhe kreative. Ato janë të përdorura prej më shumë se një miliard përdoruesve nga e gjithë bota.

Rrjetet sociale janë shumë tërheqëse dhe joshëse për fëmijë dhe adoleshentë, të cilëve ju ofrojnë mundësi të jenë kreativë në internet, të ndajnë idetë dhe të komunikojnë me të tjerët, prej miqve të vjetër deri te të panjohurit. Këto rrjete ofrojnë mundësi për t'u shprehur lirshëm, përfshirë përdorimin e videove, fotove, muzikën dhe chat-in. Më të njohurat janë Facebook, Twitter, MySpace dhe hi5.

Rreziqet nga përdorimi i rrjeteve sociale ?

Për fat të keq, shumica e fëmijëve zbulojnë shumë detaje personale në profilet e tyre dhe kjo sjellje është mjaft me rrezik. Të dhënat e publikuara mund të keqpërdoren lehtësisht dhe mund të dëmtojnë fëmijët tani dhe tu shkaktojnë shqetësime edhe në të ardhmen, p.sh. kur ata kërkojnë punë apo ngritje në karrierë profesionale. Ka shumë forma të rreziqeve potenciale që shfaqen nga përdorimi jo i sigurt dhe i tepruar i rrjeteve sociale, mirëpo më të shpeshtat janë këto:

- Postimi i të dhënave personale të dukshme për secilin që dëshiron t'i shohë, përfshirë fotografitë, videot, numrin e telefonit mobil, adresën;
- Kontakti me persona të panjohur;
- Sajberdhuna;
- Viruset dhe mesazhet e padëshiruara;
- Qëndrimi i gjatë në rrjetet sociale dhe varësia nga to.



Fëmijë duhet ta kuptojnë se...

- Përmbajtjet që publikohen një herë mund të kopjohen, ndryshohen, ripunohen dhe ripublikohen nga të tjerët;
- Grabitqarët dhe sajberdhunuesve nuk e kanë shumë të vështirë të kenë qasje në informata tuaja personale;
- Informatat të cilat janë publikuar në internet, përmes motorëve të kërkimit si google, bing, yahoo, etj. mund të rishfaqen përsëri edhe pas shumë vitesh;
- Nëse dëshirohet të fshihet identiteti, nuk duhet përdoret foto që mundësojnë identifikimin tuaj. Emri dhe fotoja e profilit janë publike;
- Dërgimi ose postimi i fotografive të personave të tjerë në internet, pa lejen e tyre, e sidomos fotografi turpëruese ose intime/personale është sjellje e rrezikshme dhe për këtë rrezikoni edhe sanksione penale;
- Moshë minimale e lejuar për të hapur profil në Facebook apo Messenger është mosha 13 vjeçare dhe fëmijët e kësaj moshe zakonisht nuk janë në gjendje të vendosin parametrat e privatësisë;
- Kontakti me njerëz të panjohur mund të jetë i rrezikshëm. ASNJËHERË nuk duhet të takoheni me personat që i njihni vetëm online. Ju nuk e dini se kush ata janë në të vërtetë;
- Nëse dikush ju dërgon ndonjë mesazh që ju bënë të ndjeheni të mërzitur ose të shqetësuar duhet njoftuar menjëherë prindin ose mesuesin;
- Nuk duhet hapur "fajllat" apo "vegzat" përveç nëse e dini sigurt se çfarë janë ato;
- Ekziston jetë edhe jashtë rrjeteve sociale. Jetoje jetën;

Prindërit duhet të luajnë një rol aktiv në atë se si fëmijët përdorin faqet e rrjeteve sociale dhe duhet të qëndrojnë krah për krah në veprimtarinë e tyre në internet.

Teknologjia sot është bërë pjesë e jetës së fëmijëve dhe është shumë e logjikshme që ata të jenë më të avancuar në teknologji se ju. Mos hezitoni të kërkonin ndihmën e tyre për gjërat që ju interesojnë.

Inkurajoni fëmijën tuaj:

- Të mbajë fjalëkalimet e tij vetëm për vete;
- Të kontrollojë parametrat e privatësisë në profilin e tij. Diskutoni me fëmijët lidhur me mundësinë e rregullimit të privatësisë;
- Të mbajë profilin e tij të hapur vetëm për miqtë, e jo për publik ku mund të ketë qasje çdokush;
- Të mendojë mirë para se të postojë një foto, video sepse ajo që publikohet një herë nuk kthehet më mbrapa;
- Të bisedojë me ju nëse ai ndihet i kërcënuar nga ndokush online, ose mëson se ndonjë shok i tij mund të lëndojë veten;
- Të postojë informacione për të cilat ju dhe ai nuk do të ndiheni keq nëse i shohin edhe të tjerët.

